



Spitali Katolik Zoja e Këshillit të Mirë

PËRKUSHTUAR SHËNDETIT

RREGULLORE SHËNDETËSORE

Tiranë 2022

PËRMBAJTJA

Neni 1 - Qëllimi	3
Neni 2- Koordinatori i Njesisë të Sëmundjeve të Brendshme	3
Neni 3 - Koordinatori i Njesisë të Sëmundjeve Kirurgjikale	4
Neni 4 - Koordinatori i Njesisë së Shërbimeve Anesteziologjike dhe Reanimacionit	4
Neni 5 - Koordinatori i Njesisë të Stomatologjisë	6
Neni 6 - Koordinatori i Njesisë së Diagnozës me Imazhe dhe Radiologjisë Intervencionuese	6
Neni 7 - Koordinatori i Njesisë së Laboratorëve	7
Neni 8 - Koordinatori i Infermierisë (Kryeinfermieri i Përgjithshëm)	8
Neni 9 - Mjek Specialist i Specialiteteve të Sëmundjeve të Brendshme	9
Neni 10 - Mjek Specialist i Specialiteteve Kirurgjikale	10
Neni 11 - Mjek Specialist i Diagnozës me Imazhe dhe Radiologjisë Intervencionuese.....	11
Neni 12 - Mjek Specialist i Anestezi Reanimacionit	12
Neni 13 - Mjek Stomatolog	13
Neni 14 - Mjek Specialist i Laboratorit	14
Neni 15 - Koordinatori i Specializimeve	15
Neni 16 - Mjeku Specializant.....	15
Neni 17 - Mjeku Roje.....	16
Neni 18 - Farmacisti Spitalor	17
Neni 19 - Kryeinfermieri i Shërbimit.....	18
Neni 20 - Infermier i specializuar/shërbim shëndetësor	18
Neni 21 - Infermier i specializuar për sallë operacioni	19
Neni 22 - Teknik i Laboratorit	19
Neni 23 - Teknik i Imazherisë.....	20
Neni 24 - Fiziooterapia	20
Neni 25 - Sanitar/përgjegjës për pastrimin	21
Neni 26 - Fizikant Shëndetësor	21
Neni 27 - Inxhinier Klinik.....	21
Neni 28 - Kontrolli i Infeksioneve Spitalore.....	22

Neni 1 - Qëllimi

1). Kjo rregullore bazohet mbi Rregulloren e Përgjithshme të Spitalit Zoja e Këshillit të Mirë dhe ka për qëllim që të normojë funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave dhe funksioneve shëndetësore të spitalit

Neni 2- Koordinator i Njesisë të Sëmundjeve të Brendshme

1). Koordinator i Njesisë të Sëmundjeve të Brendshme emërohet nga Drejtori i Përgjithshëm me propozim të Drejtorit Shëndetësor. Emërohet në këtë detyrë një mjek i specializuar në një nga specialitetet e sëmundjeve të brendshme që ka një eksperience punë jo më pak se pesë vite.

2). Koordinator i Njesisë të Sëmundjeve të Brendshme bashkëpunon me Drejtorin Shëndetësor në zhvillimin e protokolleve mjekësore të çdo departamenti, dhe ka për detyrë të identifikojë, të propozojë, të zhvillojë dhe të mbikëqyrë plotësimin e të gjithë shërbimeve mjekësore duke respektuar në çdo rast kodin e etikës profesionale.

3). Koordinator i Njesisë të Sëmundjeve të Brendshme bashkëpunon për plotësimin e nevojave të spitalit me burime njerëzore.

4). Planifikon dhe ushtron gjithashtu detyrën si mjek specialist në fushën e tij të specializimit.

5). Mbikëqyr dhe zbaton detyrimet ligjore mbi mbledhjen, administrimin, arkivimin dhe raportimin e të dhënave të pacientëve nga personeli shëndetësor i koordinuar prej tij.

6). Verifikon dhe promovon zbatimin e protokolleve të përditësuara në diagnostikimin dhe trajtimin e patologjive nga personeli mjekësor i Njesisë të Sëmundjeve të Brendshme.

7). Planifikon, menaxhon dhe vlerëson shërbimet e kujdesit me synimin për të përmirësuar cilësinë.

8). Organizon në bashkëpunim me mjeket e Njesisë të Sëmundjeve të Brendshme shërbimin ambulator dhe atë ndaj pacientëve të trajtuar në regjim shtrimi.

9). Koordinon bashkëpunimin me njësitë e tjera të spitalit për të siguruar mbarëvajtjen dhe ruajtjen e cilësisë së shërbimeve.

10). Koordinon në bashkëpunim me kryeinfermierët dhe me inxhinieret përkatës të shërbimeve mbështetëse monitorimin e funksionimit të aparaturave mjekësore në përdorim të tij dhe të stafit të tij dhe bashkëpunon në procesin e mirëmbajtje/riparimit të tyre.

11). Promovon, koordinon dhe organizon trajnimin e stafit mjekësor dhe infermieror në përdorimin e aparaturave të reja, përditësimin shkencor dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit mjekësor në Njesisë të Sëmundjeve të Brendshme.

Neni 3 - Koordinator i Njesisë të Sëmundjeve Kirurgjikale

- 1). Koordinator i Njesisë të Sëmundjeve Kirurgjikale emërohet nga Drejtori i Përgjithshëm me propozim të Drejtorit Shëndetësor. Emërohet në këtë detyrë një mjek i specializuar në një nga specialitetet e sëmundjeve kirurgjikale që ka një eksperience pune jo më pak se pesë vite.
- 2). Koordinator i Njesisë të Sëmundjeve Kirurgjikale bashkëpunon me Drejtorin Shëndetësor në zhvillimin e protokolleve mjekësore të çdo specialiteti, dhe ka për detyrë të identifikojë, të propozojë, të zhvillojë dhe të mbikëqyrë plotësimin e të gjithë shërbimeve mjekësore, duke respektuar në çdo rast kodin e etikës profesionale.
- 3). Koordinator i Njesisë të Sëmundjeve Kirurgjikale bashkëpunon për plotësimin e nevojave të spitalit me burime njerëzore.
- 4). Planifikon dhe ushtron gjithashtu detyrën si mjek specialist në fushën e tij të specializimit.
- 5). Verifikon dhe promovon aplikimin e protokolleve të përditësuara në diagnostikimin dhe trajtimin e patologjive nga personeli mjekësor i Njesisë së Sëmundjeve Kirurgjikale
- 6). Planifikon, menaxhon dhe vlerëson shërbimet e kujdesit me synimin për të përmirësuar cilësinë.
- 7). Mbikëqyr dhe zbaton detyrimet ligjore mbi mbledhjen, administrimin, arkivimin dhe raportimin e të dhënave të pacientëve nga personeli shëndetësor i koordinuar prej tij.
- 8). Organizon në bashkëpunim me mjeket e Njesisë të Sëmundjeve Kirurgjikale shërbimin ambulator dhe atë ndaj pacientëve të trajtuar në regjim shtrimi.
- 9). Është përgjegjës për mbarëvajtjen dhe koordinimin e punës së komplekseve të sallave të operacionit në bashkëpunim me Kryeinfermierin e Sallave të Operacionit dhe aktorët e tjerë të përfshirë në aktivitetin e tyre.
- 10). Koordinon në bashkëpunim me kryeinfermierët dhe me inxhinierët përkatës të shërbimeve mbështetëse monitorimin e funksionimit të aparaturave mjekësore në përdorim të tij dhe të stafit të tij dhe bashkëpunon në procesin e mirëmbajtje/riparimit të tyre.
- 11). Koordinon bashkëpunimin me njësitë e tjera të Spitalit për të siguruar mbarëvajtjen dhe ruajtjen e cilësisë së shërbimeve të dhëna.
- 12). Promovon, koordinon dhe organizon trajnimin e stafit mjekësor dhe infermieror në përdorimin e aparaturave të reja, përditësimin shkencor dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit mjekësor në Njësinë e Sëmundjeve Kirurgjikale.

Neni 4 - Koordinator i Njesisë së Shërbimeve Anesteziologjike dhe Reanimacionit

- 1). Koordinator i Njesisë të Shërbimeve Anesteziologjike dhe Reanimacionit emërohet nga Drejtori i Përgjithshëm me propozim të Drejtorit Shëndetësor. Emërohet në këtë detyrë një mjek i specializuar në fushën e anesteziës dhe reanimacionit që ka një eksperience pune jo më pak se pesë vite.

- 2). Koordinator i Njesisë të Shërbimeve Anesteziologjike dhe Reanimacionit bashkëpunon me Drejtorin Shëndetësor në zhvillimin e protokolleve mjekësore të çdo specialiteti, dhe ka për detyrë të identifikojë, të propozojë, të zhvillojë dhe të mbikëqyrë plotësimin e të gjithë shërbimeve mjekësore, duke respektuar në çdo rast kodin e etikës profesionale.
- 3). Koordinator i Njesisë të Shërbimeve Anesteziologjike dhe Reanimacionit bashkëpunon për plotësimin e nevojave të spitalit me burime njerëzore.
- 4). Planifikon dhe ushtron gjithashtu detyrën si mjek specialist në fushën e tij të specializimit.
- 5). Verifikon dhe promovon zbatimin e protokolleve të përditësuara në diagnostikimin dhe trajtimin e patologjive nga personeli mjekësor i Njesisë të Shërbimeve Anesteziologjike dhe Reanimacionit.
- 6). Planifikon, menaxhon dhe vlerëson shërbimet e kujdesit të specialitetit përkatës me synimin për të përmirësuar cilësinë.
- 7). Koordinon në bashkëpunim me Kryeinfermierin e Përgjithshëm dhe kryeinfermierët e njësive klinike për disponibilitetin dhe funksionalitetin e dispozitivëve për dhënien e ndihmës së parë në ambientet e secilës prej njësive.
- 8). Organizon në bashkëpunim me mjeket e Njesisë së Shërbimeve Anesteziologjike dhe Reanimacionit, me koordinatorët e njësive të tjera dhe mjekët specialistë të fushave të ndryshme, shërbimin ambulator dhe atë ndaj pacientëve të trajtuar në regjim shtrimi.
- 9). Mbikëqyr dhe zbaton detyrimet ligjore mbi mbledhjen, administrimin, arkivimin dhe raportimin e të dhënave të pacientëve nga personeli shëndetësor i koordinuar prej tij.
- 10). Është përgjegjës për mbarëvajtjen dhe koordinimin e aktivitetit anesteziologjik të komplekseve të sallave të operacionit në bashkëpunim Koordinatorin e Njesisë të Sëmundjeve Kirurgjikale, me Kryeinfermierin e Sallave të Operacionit dhe aktorët e tjerë të përfshirë në këtë veprimtari.
- 11). Koordinon në bashkëpunim me Kryeinfermierin e Sallave të Operacionit dhe të Reanimacionit si dhe me inxhinierët përkatës të shërbimeve mbështetëse monitorimin e funksionimit të aparaturave mjekësore në përdorim të tij dhe të stafit të tij dhe bashkëpunon në procesin e mirëmbajtje/riparimit të tyre.
- 12). Është përgjegjës për koordinimin dhe mbarëvajtjen e aktivitetit të reanimacionit duke u kujdesur për optimizimin e këtij aktiviteti si në këndvështrimin e cilësisë të shërbimit ashtu dhe të racionalizimit të tij.
- 13). Koordinon bashkëpunimin me njësitë e tjera të spitalit për të siguruar mbarëvajtjen dhe ruajtjen e cilësisë së shërbimeve të dhëna.
- 14). Promovon, koordinon dhe organizon trajnimin e stafit mjekësor dhe infermieror në përdorimin e aparaturave të reja, përditësimin shkencor dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit mjekësor në Njesisë të Shërbimeve Anesteziologjike dhe Reanimacionit

Neni 5 - Koordinator i Njesisë të Stomatologjisë

- 1). Koordinator i Njesisë së Stomatologjisë emërohet nga Drejtori i Përgjithshëm me propozim të Drejtorit Shëndetësor. Emërohet në këtë detyrë një Mjek Stomatolog i Specializuar që ka një eksperience pune jo më pak së pesë vite.
- 2). Koordinator i Njesisë së Stomatologjisë bashkëpunon me Drejtorin Shëndetësor në zhvillimin e protokolleve mjekësore, dhe ka për detyrë të identifikojë, të propozojë, të zhvillojë dhe të mbikqyrë plotësimin e të gjithë shërbimeve mjekësore, duke respektuar në çdo rast kodin e etikës profesionale.
- 3). Koordinator i Njesisë së Stomatologjisë bashkëpunon për plotësimin e nevojave të spitalit me burime njerëzore.
- 4). Planifikon dhe ushtron gjithashtu detyrën si stomatolog në fushën e tij të specializimit.
- 5). Verifikon dhe promovon zbatimin e protokolleve të përditësuara në diagnostikimin dhe trajtimin e patologjive nga personeli mjekësor i Njesisë së Stomatologjisë
- 6). Planifikon, menaxhon dhe vlerëson shërbimit e kujdesit me synimin për të përmirësuar cilësinë.
- 7). Mbikëqyr dhe zbaton detyrimet ligjore mbi mbledhjen, administrimin, arkivimin dhe raportimin e të dhënave të pacientëve nga personeli shëndetësor i koordinuar prej tij.
- 8). Organizon në bashkëpunim me mjekët e Njesisë së Stomatologjisë shërbimin ambulator.
- 9). Është përgjegjës për mbarëvajtjen dhe koordinimin e punës së komplekseve të studiove odontoatrike në bashkëpunim me infermierët dhe aktorët e tjerë të përfshirë në aktivitetin e tyre.
- 10). Koordinon në bashkëpunim me infermierët dhe me inxhinierët përkatës të shërbimeve mbështetëse monitorimin e funksionimit të aparaturave mjekësore në përdorim të tij dhe të stafit të tij dhe bashkëpunon në procesin e mirëmbajtje/riparimit të tyre.
- 11). Koordinon bashkëpunimin me njësitë e tjera të spitalit për të siguruar mbarëvajtjen dhe ruajtjen e cilësisë së shërbimeve të dhëna.
- 12). Promovon, koordinon dhe organizon trajnimin e stafit në përdorimin e aparaturave te reja, përditësimin shkencor dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit mjekësor në Njësinë e Stomatologjisë.

Neni 6 - Koordinator i Njesisë së Diagnozës me Imazhe dhe Radiologjisë Intervencionuese

- 1). Koordinator i Njesisë të Diagnozës me Imazhe dhe Radiologjisë Intervencionuese emërohet nga Drejtori i Përgjithshëm me propozim të Drejtorit shëndetësor. Emërohet në këtë detyrë një mjek i specializuar në imazheri që ka një eksperience pune jo më pak se pesë vite.
- 2). Koordinator i Njesisë të Diagnozës me Imazhe dhe Radiologjisë Intervencionuese bashkëpunon me Drejtorin Shëndetësor në zhvillimin e protokolleve mjekësore, dhe ka për detyrë të identifikojë, të propozojë,

të zhvillojë dhe të mbikëqyrë plotësimin e të gjithë shërbimeve mjekësore, duke respektuar në çdo rast kodin e etikës profesionale.

3). Koordinator i Njesisë të Diagnozës me Imazhe dhe Radiologjisë Intervencionuese bashkëpunon për plotësimin e nevojave të spitalit me burime njerëzore.

4). Planifikon dhe ushtron gjithashtu detyrën si mjek specialist në fushën e tij të specializimit.

5). Verifikon dhe promovon aplikimin e protokolleve të përditësuara në diagnostikimin dhe trajtimin e patologjive nga personeli mjekësor i Njesisë të Diagnozës me Imazhe dhe Radiologjisë Intervencionuese.

6). Është përgjegjës për zbatimin në njësinë që koordinon, të masave për ruajtjen e vetes dhe të kolegëve nga ekspozimi ndaj agjenteve potencialisht dëmtues për shëndetin e tyre.

7). Mbikëqyr dhe zbaton detyrimet ligjore mbi mbledhjen, administrimin, arkivimin dhe raportimin e të dhënave të pacientëve nga personeli shëndetësor i koordinuar prej tij.

8). Koordinon në bashkëpunim me Përgjegjësën e Teknikëve të Imazherisë dhe me inxhinierët përkatës të shërbimeve mbështetëse monitorimin e funksionimit të aparaturave mjekësore në përdorim të tij dhe të stafit të tij dhe bashkëpunon në procesin e mirëmbajtje/riparimit të tyre.

9). Organizon në bashkëpunim me mjekët e Njesisë të Diagnozës me Imazhe dhe Radiologjisë Intervencionuese, me koordinatorët e njësive të tjera dhe me mjekët specialistë të fushave të ndryshme, shërbimin ndaj pacientëve ambulatorialë dhe atë ndaj pacientëve të trajtuar në regjim shtrimi.

10). Është përgjegjës për koordinimin dhe mbarëvajtjen e aktivitetit të Njesisë të Diagnozës me Imazhe dhe Radiologjisë Intervencionuese, duke u kujdesur për optimizimin e këtij aktiviteti si në këndvështrimin e cilësisë të shërbimit ashtu dhe të racionalizimit të tij.

11). Promovon, koordinon dhe organizon trajnimin e stafit mjekësor dhe infermieror në përdorimin e aparaturave të reja, përditësimin shkencor dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit mjekësor në Njesisë të Diagnozës me Imazhe dhe Radiologjisë Intervencionuese.

Neni 7 - Koordinator i Njesisë së Laboratorëve

1). Koordinator i Njesisë të Laboratorëve emërohet nga Drejtori i Përgjithshëm me propozim të Drejtorit Shëndetësor. Emërohet në këtë detyrë një mjek i specializuar në mjekësi laborator që ka një eksperience pune jo më pak se pesë vite.

2). Koordinator i Njesisë të Laboratorëve bashkëpunon me Drejtorin Shëndetësor në zhvillimin e protokolleve mjekësore, dhe ka për detyrë të identifikojë, të propozojë, të zhvillojë dhe të mbikëqyrë plotësimin e të gjithë shërbimeve mjekësore, duke respektuar në çdo rast kodin e etikës profesionale.

3). Koordinator i Njesisë të Laboratorëve bashkëpunon për plotësimin e nevojave të spitalit me burime njerëzore.

- 4). Planifikon dhe ushtron gjithashtu detyrën si mjek specialist në fushën e tij të specializimit.
- 5). Verifikon dhe promovon aplikimin e protokolleve të përditësuara në diagnostikimin e patologjive nga personeli mjekësor i Njesisë të Laboratorëve.
- 6). Është përgjegjës për zbatimin në njësinë që koordinon, të masave për ruajtjen e vetes dhe të kolegëve nga ekspozimi ndaj agjenteve potencialisht dëmtesues për shëndetin e tyre.
- 8). Mbikëqyr dhe zbaton detyrimet ligjore mbi mbledhjen, administrimin, arkivimin dhe raportimin e të dhënave të pacientëve nga personeli shëndetësor i koordinuar prej tij.
- 9). Koordinon në bashkëpunim me Përgjegjësën e Teknikëve të Laboratorit dhe me inxhinierët përkatës të shërbimeve mbështetëse monitorimin e funksionimit të aparaturave mjekësore në përdorim të tij dhe të stafit të tij dhe bashkëpunon në procesin e mirëmbajtje/riparimit të tyre.
- 10). Organizon në bashkëpunim me mjekët e Njesisë të Laboratorëve, me koordinatorët e njësive të tjera dhe me mjekët specialistë të fushave të ndryshme, shërbimin ndaj pacientëve ambulatorialë dhe atë ndaj pacientëve të trajtuar në regjim shtrimi.
- 11). Është përgjegjës për koordinimin dhe mbarëvajtjen e aktivitetit të laboratorëve duke u kujdesur për optimizimin e këtij aktiviteti si në këndvështrimin e cilësisë të shërbimit ashtu dhe të racionalizimit të tij.
- 12). Promovon, koordinon dhe organizon trajnimin e stafit mjekësor dhe teknik në përdorimin e aparaturave të reja, përditësimin shkencor dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit mjekësor në Njesisë të Laboratorëve.

Neni 8 - Koordinator i Infermierisë (Kryeinfermieri i Përgjithshëm)

- 1). Koordinator i infermierisë (Kryeinfermieri i Përgjithshëm) bën pjesë në Drejtorinë e Spitalit. Koordinator i infermierisë emërohet dhe shkarkohet nga Drejtori i Përgjithshëm. Emërohet si Koordinator i Infermierisë një i diplomuar që ka një diplomë master në shkencë infermieristike dhe përvojë më shumë se pesë vjet në funksione drejtuese në sektorin shëndetësor.
- 2). Koordinator i Infermierisë është elementi qendror për motivimin e grupit në fushën e kujdesit infermieror, duke përdorur përvojën e tij, njohuritë e marra në rrugëtimin e formimit dhe sistemet e informacionit në dispozicion. Koordinator duhet të stimulojë operatorët e tij të punojnë duke u kujdesur për organizimin, zbatimin e shërbimit infermieror në të gjithë spitalin dhe respektimin e parimeve etike.
- 3). Koordinator i Infermierisë planifikon, menaxhon, zbaton, monitoron dhe vlerëson ndërhyrjen infermiore, garanton zbatimin e saktë të dispozitave mjekësore diagnostiko-terapeutike; vepron si individualisht ashtu edhe në bashkëpunim me profesionistë të tjerë shëndetësorë e sociale; përdor, kur është e nevojshme, stafin mbështetës të përcaktuar nga Drejtoria.

4). Koordinator i Infermierisë në thelb mban një pozicion drejtues, duke kryer detyra mbikëqyrëse. Ai është përgjegjës për menaxhimin, organizimin dhe planifikimin strategjik të njësisë së infermierisë brenda SZKM.

5). Në aktivitetin e tij mbështetet dhe operon nëpërmjet kryeinfermierëve të njësive përbërëse të shërbimit klinik-diagnostik-terapeutik apo ekuivalentëve të tyre.

6). Detyrat e tij më hollësisht janë të përshkruara në Rregulloren Teknike Mjekësore të SZKM.

Neni 9 - Mjek Specialist i Specialiteteve të Sëmundjeve të Brendshme

1). Mjeku specialist i sëmundjeve të brendshme emërohet nga Drejtori i Përgjithshëm me propozim të Drejtorit Shëndetësor duke vlerësuar kurrikulën dhe duke u bazuar në nevojat e arsyetuara të institucionit për shërbimet e këtij profesionisti.

2). Mjeku specialist i sëmundjeve të brendshme aktivizohet mbi bazën e kontratës individuale dhe mund të ketë funksione të mjekut të punësuar me kohë të plotë, me kohë të pjesshme apo me modalitete të tjera të dakordësuara nga kontrata.

3). Mjeku specialist i sëmundjeve të brendshme duhet të jetë i licensuar për ushtrimin e profesionit të mjekut dhe për specialitetin përkatës sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë me përjashtim të rasteve kur ushtron me të drejta të kufizuara funksionet e konsulentit.

4). Detyrat dhe përgjegjësitë:

- a. Zhvillon aktivitetin e tij profesional të koordinuar nga Koordinator i Njësisë të Sëmundjeve të brendshme, sipas termave të kontratës duke qenë bashkëpunues në plotësimin e nevojave të institucionit në shërbimin ambulatorial, atë diagnostik-terapeutik dhe ndaj pacientëve të trajtuar në regjim shtrimi.
- b. Kryen ekzaminimin, diagnostikimin, mjekimin dhe ndjekjen e pacientëve ambulatorë në specialitetin e tij, duke zbatuar protokollet, udhëzimet dhe rregulloret në fuqi.
- c. Sipas një plani të aprovuar nga Koordinator i Njësisë së Sëmundjeve të Brendshme, zhvillon informimin shëndetësor tek të sëmurët e tij, jep me shkrim udhëzime për të sëmurin pas daljes nga spitali në lidhje me barnat, me ekzaminimet që duhet të kryejë dhe në lidhje me terapinë.
- d. Organizon punën në mjedisin e tij të punë, duke plotësuar një dokumentacion të plotë mbi sëmundshmërinë dhe trajtimin e të sëmurëve që ndjek në bazë të skemave të mjekimit.
- e. Zbaton me rigorozitet masat për ruajtjen e vetes dhe të kolegëve nga ekspozimi ndaj agjenteve potencialisht dëmtues për shëndetin e tyre.
- f. Zbaton ligjshmërinë, disiplinën në punë dhe kodin e etikës dhe deontologjisë mjekësore duke u angazhuar në ruajtjen e sekretit profesional.

- g. Raporton tek koordinatori i njësisë mbi problematika të lidhura me parregullsi të verifikuara prej tij në aktivitetin e njësisë dhe në problematika të lidhura me mangësi në funksionimin e aparaturave apo mjeteve në përdorim të tij.
- h. Merr pjesë në aktivitetet e parashikuara për edukimin në vazhdim, si referenca, ekspozime, analiza, etj. dhe inkuadrohet në punën shkencore të strukturës sipas një plani të aprovuar nga drejtuesi i njësisë; po ashtu punon për ngritjen tekniko – profesionale të tij.
- i. Mbart edhe pas përfundimit të raportit të punës detyrimin e ruajtjes të sekretit profesional lidhur me informacione mbi pacientët dhe mbi aktivitetin e institucionit sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 10 - Mjek Specialist i Specialiteteve Kirurgjikale

- 1). Mjeku specialist i sëmundjeve kirurgjikale emërohet nga Drejtori i Përgjithshëm me propozim të Drejtorit Shëndetësor duke vlerësuar kurrikulën, dhe duke u bazuar në nevojat e arsyetuara të institucionit për shërbimet e këtij profesionisti.
- 2). Mjeku specialist i sëmundjeve kirurgjikale aktivizohet mbi bazën e kontratës individuale dhe mund të ketë funksione të mjekut të punësuar me kohë të plotë, me kohë të pjeshme apo me modalitete të tjera të dakordësuara nga kontrata.
- 3). Mjeku specialist i sëmundjeve kirurgjikale duhet të jetë i licencuar për ushtrimin e profesionit të mjekut dhe për specialitetin përkatës sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë me përjashtim të rasteve kur ushtron me të drejta të kufizuara funksionet e konsulentit.
- 4). Detyrat dhe përgjegjësitë:
 - a) Zhvillon aktivitetin e tij profesional të koordinuar nga Koordinatori i Njësisë të Sëmundjeve Kirurgjikale sipas termave të kontratës, duke qenë bashkëpunues në plotësimin e nevojave të institucionit në shërbimin ambulatorial, atë diagnostik–terapeutik dhe ndaj pacientëve të trajtuar në regjim shtrimi.
 - b) Kryen ekzaminimin, diagnostikimin, mjekimin dhe ndjekjen e pacientëve ambulatorë në specialitetin e tij, duke zbatuar protokollet, udhëzimet dhe rregulloret në fuqi.
 - c) Sipas një plani të aprovuar nga Koordinatori i Njësisë të Sëmundjeve të Kirurgjikale, zhvillon informimin shëndetësor tek të sëmurët e tij, jep me shkrim udhëzime për të sëmurin pas daljes nga spitali në lidhje me barnat, me ekzaminimet që duhet të kryejë dhe në lidhje me terapinë.
 - d) Organizon punën në ambientin e punës së tij, duke plotësuar një dokumentacion të plotë mbi sëmundshmërinë dhe trajtimin e të sëmurëve që ndjek në bazë të skemave të mjekimit.
 - e) Zbaton me rigorozitet masat për ruajtjen e vetes dhe të kolegëve nga ekspozimi ndaj agjenteve potencialisht dëmtues për shëndetin e tyre.

- f) Zbaton ligjshmërinë, disiplinën në punë dhe kodin e etikës dhe deontologjisë mjekësore duke u angazhuar në ruajtjen e sekretit profesional.
- g) Raporton tek Koordinatori i Njesisë mbi problematika të lidhura me parregullsi të verifikuara prej tij në aktivitetin e njesisë dhe në problematika të lidhura me mangësi në funksionimin e aparaturave apo mjeteve në përdorim të tij.
- h) Merr pjesë në aktivitetet e parashikuara për edukimin në vazhdim, si referenca, ekspozime, analiza, etj. dhe inkuadrohet në punën shkencore të strukturës sipas një plani të aprovuar nga drejtuesi i njesisë; po ashtu punon për ngritjen tekniko – profesionale të tij.
- i) Mbart edhe pas përfundimit të raportit të punës detyrimin e ruajtjes të sekretit profesional lidhur me informacione mbi pacientët dhe mbi aktivitetin e Institucionit sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 11 - Mjek Specialist i Diagnozës me Imazhe dhe Radiologjisë Intervencionuese

1). Mjeku Specialist i Diagnozës me Imazhe dhe Radiologjisë Intervencionuese emërohet nga Drejtori i Përgjithshëm me propozim të Drejtorit Shëndetësor duke vlerësuar kurrikulën, dhe duke u bazuar në nevojat e arsyetuara të institucionit për shërbimet e këtij profesionisti.

2). Mjeku specialist i sëmundjeve kirurgjikale aktivizohet mbi bazën e kontratës individuale dhe mund të ketë funksione të mjekut të punësuar me kohë të plotë, me kohë të pjesshme apo me modalitete të tjera të dakordësuara nga kontrata.

3). Mjeku specialist i sëmundjeve kirurgjikale duhet të jetë i licencuar për ushtrimin e profesionit të mjekut dhe për specialitetin përkatës sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë me përjashtim të rasteve kur ushtron me të drejta të kufizuara funksionet e konsulentit.

4). Detyrat dhe përgjegjësitë:

- a) Zhvillon aktivitetin e tij profesional të koordinuar nga Koordinatori i Njesisë të Diagnozës me Imazhe dhe Radiologjisë Intervencionuese sipas termave të kontratës duke qenë bashkëpunues në zbatimin e nevojave të institucionit në shërbimin ambulatorial, atë diagnostik–terapeutik dhe ndaj pacientëve të trajtuar në regjim shtrimi.
- b) Kryen ekzaminimin, diagnostikimin, trajtimin dhe ndjekjen e pacientëve, duke zbatuar protokollin, udhëzimet dhe rregulloret në fuqi.
- c) Sipas një plani të aprovuar nga Koordinatori i Njesisë të Diagnozës me Imazhe dhe Radiologjisë Intervencionuese, zhvillon informimin shëndetësor tek të sëmurët e tij, dhe kur është në rolin e kuruesit të drejtpërdrejtë, jep udhëzime për të sëmurin në lidhje me barnat, me ekzaminimet që duhet të kryejë dhe në lidhje me terapinë.
- d) Organizon punën në ambientin e punës së tij, duke plotësuar një dokumentacion të plotë mbi sëmundjet dhe trajtimin e të sëmurëve që ndjek.

- e) Zbaton me rigorozitet masat për ruajtjen e vetes dhe të kolegëve nga ekspozimi ndaj agjenteve potencialisht dëmtues për shëndetin e tyre.
- f) Zbaton ligjshmërinë, disiplinën në punë dhe kodin e etikës dhe deontologjisë shëndetësore duke u angazhuar në ruajtjen e sekretit profesional.
- g) Raporton tek Koordinatori i Njesisë mbi problematika të lidhura me parregullsi të verifikuara prej tij në aktivitetin e njesisë dhe në problematika të lidhura me mangësi në funksionimin e aparaturave apo mjeteve në përdorim të tij.
- h) Merr pjesë në aktivitetet e parashikuara për edukimin në vazhdim, si referenca, ekspozime, analiza, etj. dhe inkuadrohet në punën shkencore të strukturës sipas një plani të aprovuar nga drejtuesi i njesisë; po ashtu punon për ngritjen tekniko-profesionale të tij.
- i) Mbart edhe pas përfundimit të raportit të punës detyrimin e ruajtjes të sekretit profesional lidhur me informacione mbi pacientët dhe mbi aktivitetin e Institucionit sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 12 - Mjek Specialist i Anestezi Reanimacionit

- 1). Mjeku specialist i anestezi reanimacionit emërohet nga Drejtori i Përgjithshëm me propozim të Drejtorit Shëndetësor duke vlerësuar kurrikulën, dhe duke u bazuar në nevojat e arsyetuara të institucionit për shërbimet e këtij profesionisti.
- 2). Mjeku specialist i anestezi reanimacionit aktivizohet mbi bazën e kontratës individuale dhe mund të ketë funksione të mjekut të punësuar me kohë të plotë, me kohë të pjesshme apo me modalitete të tjera të dakordësuara nga kontrata.
- 3). Mjeku specialist i anestezi reanimacionit duhet të jetë i licencuar për ushtrimin e profesionit të mjekut dhe për specialitetin përkatës sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë me përjashtim të rasteve kur ushtron me të drejta të kufizuara funksionet e konsulentit.
- 4). Detyrat dhe përgjegjësitë:
 - a) Zhvillon aktivitetin e tij profesional të koordinuar nga Koordinatori i Njesisë të Anestezi Reanimacionit sipas termave të kontratës duke qenë bashkëpunues në plotësimin e nevojave të institucionit në shërbimin ambulatorial, atë diagnostik-terapeutik dhe ndaj pacientëve të trajtuar në regjim shtrimi.
 - b) Kryen ekzaminimin, diagnostikimin, trajtimin dhe ndjekjen e pacientëve, duke zbatuar protokollet, udhëzimet dhe rregulloret në fuqi.
 - c) Sipas një plani të aprovuar nga Koordinatori i Njesisë të Anestezi Reanimacionit zhvillon informimin shëndetësor tek të sëmurët e tij, jep udhëzime për të sëmurin në lidhje me barnat, me ekzaminimet që duhet të kryejë dhe në lidhje me terapinë.

- d) Organizon punën në mjedisin e punës së tij, duke plotësuar një dokumentacion të plotë mbi sëmundjet dhe trajtimin e të sëmurëve që ndjek.
- e) Zbaton me rigorozitet masat për ruajtjen e vetes dhe të kolegëve nga ekspozimi ndaj agjenteve potencialisht dëmtues për shëndetin e tyre.
- f) Zbaton ligjshmërinë, disiplinën në punë dhe kodin e etikës dhe deontologjisë shëndetësore duke u angazhuar në ruajtjen e sekretit profesional.
- g) Raporton tek Koordinatori i Njesisë mbi problematika të lidhura me parregullsi të verifikuara prej tij në aktivitetin e njesisë dhe në problematika të lidhura me mangësi në funksionimin e aparaturave apo mjeteve në përdorim të tij.
- h) Merr pjesë në aktivitetet e parashikuara për edukimin në vazhdim, si referenca, ekspozime, analiza, etj. dhe inkuadrohet në punën shkencore të strukturës sipas një plani të aprovuar nga drejtuesi i njesisë; po ashtu punon për ngritjen tekniko-profesionale të tij.
- i) Mbart edhe pas përfundimit të raportit të punës detyrimin e ruajtjes të sekretit profesional lidhur me informacione mbi pacientët dhe mbi aktivitetin e Institucionit sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 13 - Mjek Stomatolog

- 1). Mjeku stomatolog emërohet nga Drejtori i Përgjithshëm me propozim të Drejtorit Shëndetësor duke vlerësuar kurrikulën, dhe duke u bazuar në nevojat e arsyetuara të institucionit për shërbimet e këtij profesionisti.
- 2). Mjeku stomatolog aktivizohet mbi bazën e kontratës individuale dhe mund të ketë funksione të mjekut të punësuar me kohë të plotë, me kohë të pjesshme apo me modalitete të tjera të dakordësuara nga kontrata.
- 3). Mjeku stomatolog duhet të jetë i licencuar për ushtrimin e profesionit të stomatologut dhe për specialitetin përkatës sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë .
- 4). Detyrat dhe përgjegjësitë:
 - a) Zhvillon aktivitetin e tij profesional të koordinuar nga Koordinatori i Njesisë të Stomatologjisë sipas termave të kontratës, duke qenë bashkëpunues në plotësimin e nevojave të institucionit në shërbimin ambulatorial, atë diagnostik-terapeutik dhe ndaj pacientëve të trajtuar në regjim shtrimi.
 - b) Kryen ekzaminimin, diagnostikimin, mjekimin dhe ndjekjen e pacientëve ambulatorë në specialitetin e tij, duke zbatuar protokollet, udhëzimet dhe rregulloret në fuqi.
 - c) Sipas një plani të aprovuar nga Koordinatori i Njesisë së Stomatologjisë zhvillon informimin shëndetësor tek të sëmurët e tij, jep me shkrim udhëzime për të sëmurin në lidhje me barnat, me ekzaminimet që duhet të kryejë dhe në lidhje me terapinë.

- d) Organizon punën në ambientin e punës së tij, duke plotësuar një dokumentacion të plotë mbi sëmundshmërinë dhe trajtimin e të sëmurëve që ndjek në bazë të skemave të mjekimit.
- e) Zbaton me rigorozitet masat për ruajtjen e vetes dhe të kolegëve nga ekspozimi ndaj agjenteve potencialisht dëmtues për shëndetin e tyre.
- f) Zbaton ligjshmërinë, disiplinën në punë dhe kodin e etikës dhe deontologjisë shëndetësore duke u angazhuar në ruajtjen e sekretit profesional.
- g) Raporton tek Koordinatori i Njesisë mbi problematika të lidhura me parregullsi të verifikuara prej tij në aktivitetin e njesisë dhe në problematika të lidhura me mangësi në funksionimin e aparaturave apo mjeteve në përdorim të tij.
- h) Merr pjesë në aktivitetet e parashikuara për edukimin në vazhdim, si referenca, ekspozime, analiza, etj. dhe inkuadrohet në punën shkencore të strukturës sipas një plani të aprovuar nga drejtuesi i njesisë, po ashtu punon për ngritjen tekniko – profesionale të tij.
- i) Mbart edhe pas përfundimit të raportit të punës detyrimin e ruajtjes të sekretit profesional lidhur me informacione mbi pacientët dhe mbi aktivitetin e Institucionit sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 14 - Mjek Specialist i Laboratorit

- 1). Mjeku specialist i laboratorit emërohet nga Drejtori i Përgjithshëm me propozim të Drejtorit Shëndetësor duke vlerësuar kurrikulën, dhe duke u bazuar në nevojat e arsyetuara të institucionit për shërbimet e këtij profesionisti.
- 2). Mjeku specialist i laboratorit aktivizohet mbi bazën e kontratës individuale dhe mund të ketë funksione të mjekut të punësuar me kohë të plotë, me kohë të pjesshme apo me modalitete të tjera të dakordësuara nga kontrata.
- 3). Mjeku specialist i laboratorit duhet të jetë i licencuar për ushtrimin e profesionit të mjekut dhe për specialitetin përkatës sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur ushtron me të drejta të kufizuara funksionet e konsulentit.
- 4). Detyrat dhe përgjegjësitë:
 - a) Zhvillon aktivitetin e tij profesional të koordinuar nga Koordinatori i Njesisë të Laboratorit sipas termave të kontratës, duke qenë bashkëpunues në plotësimin e nevojave të institucionit në shërbimin ambulatorial dhe ndaj pacientëve të trajtuar në regjim shtrimi.
 - b) Kryen ekzaminimin, diagnostikimin dhe ndjekjen e pacientëve, duke zbatuar protokollin, udhëzimet dhe rregulloret në fuqi.
 - c) Konvalidon rezultatin e analizave të kryera nga personeli teknik dhe është përgjegjës për kontrollin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë së analizave laboratorike
 - d) Organizon punën në mjedisin e punës së tij, duke plotësuar një dokumentacion të plotë.

- e) Zbaton me rigorozitet masat për ruajtjen e vetes dhe të kolegëve nga ekspozimi ndaj agjenteve potencialisht dëmtues për shëndetin e tyre.
- f) Zbaton ligjshmërinë, disiplinën në punë dhe kodin e etikës dhe deontologjisë shëndetësore duke u angazhuar në ruajtjen e sekretit profesional.
- g) Raporton tek koordinatori i njësisë mbi problematika të lidhura me parregullsi të verifikuara prej tij në aktivitetin e njësisë dhe në problematika të lidhura me mangësi në funksionimin e aparaturave apo mjeteve në përdorim të tij.
- h) Merr pjesë në aktivitetet e parashikuara për edukimin në vazhdim, si referenca, ekspozime, analiza, etj. dhe inkuadrohet në punën shkencore të strukturës sipas një plani të aprovuar nga drejtuesi i njësisë; po ashtu punon për ngritjen tekniko – profesionale të tij.
- i) Mbart edhe pas përfundimit të raportit të punës detyrimin e ruajtjes të sekretit profesional lidhur me informacione mbi pacientët dhe mbi aktivitetin e Institucionit sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 15 - Koordinator i Specializimeve

1). Koordinator i Specializimeve emërohet nga Drejtori i Përgjithshëm i SZKM, me propozim të Drejtorit Shëndetësor, pas marrjes së pëlqimit paraprak nga ana e Dekanit të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit Zoja e Këshillit të Mirë, nga radhët e mjekëve specialistë të punësuar nga SZKM dhe njëkohësisht pedagogë pranë Fakultetit të Mjekësisë të UKZKM me qëllim koordinimin e aktiviteteve klinike të mjekëve specializantë të angazhuar pranë spitalit me aktivitetet mësimore shkencore të detyruara në bazë të programit të tyre të specializimit afatgjatë në mjekësi.

2). Aktiviteti i koordinatori të specializimeve zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me koordinatorët e njësive në të cilat ndodhet i angazhuar mjeku specializant dhe me këshillat e programeve të specializimit afatgjatë në mjekësi, në të cilat është i regjistruar mjeku specializant.

Neni 16 - Mjeku Specializant

1). Mjeku specializant emërohet nga Drejtori i Përgjithshëm me propozim të Drejtorit Shëndetësor duke vlerësuar kurrikulën dhe duke u bazuar në nevojat e arsyetuara të institucionit për shërbimet e tij dhe duke marrë për bazë programin formativ të specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë në të cilin rezulton i reregjistruar specializanti.

2). Për një angazhim të tillë është kushtëzuese dakordësia e Këshillit të Programit të Specializimit, dhënë pas një vlerësimi të kapaciteteve formative të disponuara nga SZKM për këtë mjek specializant.

3). Mjeku specializant aktivizohet mbi bazën e kontratës individuale dhe mund të ketë funksione të mjekut të punësuar me kohë të plotë, me kohë të pjesshme apo me modalitete të tjera të dakordësuara nga kontrata.

4). Mjeku specializant duhet të jetë i licencuar për ushtrimin e profesionit të mjekut sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

5). Detyrat dhe përgjegjësitë:

- a) Zhvillon aktivitetin e tij profesional në tutelën e një tutori të aprovuar nga Këshilli i Programit të Specializimit ku është i regjistruar. Aktiviteti i tij është i koordinuar nga Koordinatori i Njesisë dhe nga Koordinatori i Specializantëve sipas termave të kontratës dhe zhvillohet duke qenë bashkëpunues në zbatimin e nevojave të institucionit.
- b) Kryen nën tutelën e tutorit ekzaminimin, diagnostikimin dhe ndjekjen e pacientëve, duke zbatuar protokollin, udhëzimet dhe rregulloret në fuqi.
- c) Organizon punën në mjedisin e punës së tij, duke plotësuar një dokumentacion të plotë.
- d) Zbaton me rigorozitet masat për ruajtjen e vetes dhe të kolegëve nga ekspozimi ndaj agjenteve potencialisht dëmtoes për shëndetin e tyre.
- e) Zbaton ligjshmërinë, disiplinën në punë dhe kodin e etikës dhe deontologjisë shëndetësore duke u angazhuar në ruajtjen e sekretit profesional.
- f) Raporton tek koordinatori i njesisë mbi problematikat të lidhura me parregullsi të verifikuara prej tij në aktivitetin e njesisë dhe në problematikat të lidhura me mangësi në funksionimin e aparaturave apo mjeteve në përdorim të tij.
- g) Mbart edhe pas përfundimit të raportit të punës detyrimin e ruajtjes të sekretit profesional lidhur me informacione mbi pacientët dhe mbi aktivitetin e Institucionit sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 17 - Mjeku Roje

1. Në spital bëjnë roje të mjekë sipas kriterëve të grafikut të bërë nga koordinatoret klinikë dhe të miratuar nga Drejtori Shëndetësor i Spitalit.
2. Shërbimi i mjekut roje organizohet sipas nevojave të vlerësuara nga Drejtori Shëndetësor në bashkëpunim me koordinatoret klinikë.
3. Kur është i parashikuar më shumë se një mjek roje, njëri nga ata caktohet përgjegjës nga Drejtori Shëndetësor dhe drejton aktivitetin 24 orësh të ekipit të rojës.
4. Mjeku roje përgjigjet për të gjithë të sëmurët e shtruar nën kujdesin e tij dhe ndjek me përparësi të sëmurët problematikë sipas shërbimeve të mjekëve kurues.
5. Mjeku roje vlerëson dhe jep ndihmën e parë në të gjitha rastet që paraqiten gjatë shërbimit të tij dhe monitoron ato deri në stabilizimin dhe transportin drejt destinacionit eventual për trajtim të mëtejshëm.
6. Kontrollon gjendjen në të gjitha repartet e shërbimit që mbulon dhe jep ndihmë shëndetësore për të sëmurët që kanë probleme.
7. Në raste të vështira thërret specialistët e tjerë për konsultë.
8. Përgjigjet për të gjitha kërkesat që bën personeli i shërbimit dhe i zgjidh ato ose vë në dijeni koordinatorin dhe në pamundësi edhe Drejtorin Shëndetësor të Spitalit.

9. Kontrollon angazhimin në punë të personelit natën.
10. Për të gjitha vizitat që bën shënon në kartelë gjëndjen e të sëmurit, mjekimin plotësues ose analizat dhe për të gjitha këto vë në dijeni mjekun kurues gjatë dorëzimit të shërbimit.
11. Në rastet e konstatimit të shkeljeve të disiplinës, merr masa deri në largimin nga puna të personave përgjegjës, por gjithmonë duke siguruar shërbimin dhe vë në dijeni koordinatorin e shërbimit.
12. Për ngjarje të jashtëzakonshme njofton Drejtorin Shëndetësor të Spitalit, në mungesë të tij zëvendësin.
13. Pasi mbaron shërbimin raporton drejtuesve të njësisë ose mjekut tjetër që ka rojen.
14. Kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga eprorët.

Neni 18 - Farmacisti Spitalor

1). Objekti i punës i Farmacistit Spitalor është furnizimi me barna dhe materiale konsumi shëndetësore, në përputhje me kërkesat e shefave të shërbimeve dhe me buxhetin vjetor të përcaktuar për to.

2). Detyrat dhe përgjegjësitë:

- a) Përgjigjet për organizimin e punës dhe zbatimin e përpiktë të legjislacionit farmaceutik.
- b) Propozon planin vjetor për furnizimin me barna e materiale shëndetësore të SZKM duke u bazuar tek kërkesat e shefave të shërbimit dhe eksperiencat paraardhëse.
- c) Siguron kushte normale të ruajtjes së medikamenteve në magazinat përkatëse.
- d) Pranon kërkesat për barna dhe materiale mjekimi nga shërbimet e ndryshme konform procedurave të qarkullimit të vlerave materiale për aktivitetin e përditshëm.
- e) Përgjigjet për ruajtjen e barnave sipas normave të praktikës së ruajtjes së mirë dhe organizon punën për qarkullimin e tyre dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të barnave të skaduara në bashkëpunim me financën me proces-verbal dhe sipas rregullave të ruajtjes së mjedisit.
- f) Ndjek kontratat e furnizimit me barna e materiale shëndetësore.
- g) Propozon blerjet e vogla apo shtesat e kontratave në fillim të vitit për plotësimin e mungesave në barna e materiale shëndetësore.
- h) Mban përgjegjësi materiale për të gjithë inventarin e barnave që ka në ngarkim në farmacinë e spitalit.
- i) Përgjigjet për ruajtjen, shpërndarjen dhe evidencën e barnave narkotike, psikotrope dhe helme.
- j) Përgatit informacion për shefin e shërbimit dhe Drejtorin Shëndetësor në lidhje me skadencat, stoqet dhe realizimin e kontratave të furnizimit.
- k) Përmbledh kërkesat e shefave të shërbimeve për medikamente dhe materiale mjekimi dhe përmbledhësen e këtyre kërkesave e paraqet në drejtori çdo fillim viti financiar.

- 1) Relaton për përpilimin përfundimtar të kërkesës vjetore për barna dhe materiale mjekimi, mbi gjendjen e farmacisë dhe konsumin mujor të tyre.

Neni 19 - Kryeinfermieri i Shërbimit

1). Kryeinfermieri i Shërbimit është figura që i jep dinamizëm strukturës dhe ndihmon në ofrimin e një shërbimi sa më cilësor. Ai zotëron dhe analizon perspektivat e kujdesjeve infermierore duke i adoptuar me metodat e reja të teknologjisë.

2). Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Ka varësi të kombinuar nga Kryeinfermieri i Përgjithshëm dhe nga koordinatorët e njësive ku ushtron funksionet e tij.
- Përcakton dhe menaxhon numrin e infermierëve që do të ketë në varësi të drejtpërdrejtë.
- Mbikëqyr, koordinon dhe kontrollon zbatimin e përkujdesjeve infermierore në mënyrë cilësore dhe në përputhje me objektivat e caktuara.
- Organizon punën për kryerjen e detyrave të ngarkuara në bashkëpunim me specialistët dhe pjesën tjetër të stafit të administratës.
- Monitoron dhe raporton tek eprorët për efektivitetin e punës së stafit nën varësi.
- Propozon ndryshimet strukturore për përkujdesjen infermierore në SZKM.
- Është përgjegjës për sigurimin e shërbimit të përkujdesjes në mjekimin, trajtimin, informimin dhe edukimin e pacientëve brenda kompetencave, sipas rregulloreve dhe ligjeve në fuqi.
- Vlerëson në mënyrë të vazhdueshme cilësinë e përkujdesjes dhe ndërmerr studime që synojnë përmirësimin e saj.
- Organizon, monitoron dhe ndjek edukimin në vazhdim të stafit nën varësi.
- Monitoron prezencën e personelit në punë dhe zbatimin korrekt të orarit të punës.
- Mbikëqyr zbatimin e ndarjes së mbetjeve të rrezikshme, transportin dhe hedhjen e tyre nëpër kontenierët e caktuar.
- Bashkëpunon me ekipin shëndetësor.
- Garanton një komunikim të përshtatshëm me pacientin dhe familjarët.
- Mbikëqyr orarin e punës dhe etikën profesionale duke qenë shembull personal.

Neni 20 - Infermier i specializuar/shërbim shëndetësor

1). Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- a) Zbaton urdhrat e koordinatorëve të njësive, Kryeinfermierit dhe mjekëve lidhur me aktivitetin e tij infermieror.
- b) Realizon pritjen, akomodimin e pacientit dhe kryen veprimet e monitorimit të tij.
- c) Njihet me patologjinë e të sëmurit.
- d) Është përgjegjës për rregullin dhe për zbatimin e standardeve higjieno-sanitare në ambientin e tij të punës.
- e) Njeh dhe përdor të gjitha llojet e aparaturave që disponon spitali që lidhen me kujdesin infermieror dhe mirëmban ato.
- f) Siguron gatishmërinë e funksionit të aparaturave dhe njofton kryeinfermierin për çdo defekt të tyre.
- g) Zbaton protokollet e mjekimit e të kujdesit infermieror.
- h) Bashkëpunon me ekipin për përkujdesjet infermierore ndaj të sëmurit.
- i) Përgjigjet për marrjen, dorëzimin dhe vendosjen në kartelë të të gjitha analizave laboratorike dhe ekzaminimeve të tjera komplementare.

- j) Merr në dorëzim të gjithë mostrat e analizave urgjente të marra duke respektuar normat përkatëse.
- k) Dërgon mostrat e analizave laboratorike, si gjak, urinë etj., në laborator duke i dorëzuar me fletore të veçantë.
- l) Udhëzon të sëmurët për ato analiza apo ekzaminime që kërkojnë procedura paraprake të posaçme.
- m) Shoqëron të sëmurët në ekzaminime imazherike, skopi, grafi, ekografi, etj., duke u interesuar për shënimet përkatëse në kartela.
- n) Kujdeset dhe në rastet kur është e nevojshme ndihmon drejtpërdrejt të sëmurët në realizimin e nevojave të tyre personale dhe higjieno-sanitare.

Neni 21 - Infermier i specializuar për sallë operacioni

1). Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- a) Kryen të gjitha procedurat e kujdesit infermior në kompleksin operator sipas nivelit kualifikues dhe asiston me mjekun në finalizimin e procedurave.
- b) Përgjigjet për sterilitetin dhe higjienën në repartin e kirurgjisë dhe merr pjesë në larjen e instrumenteve, dezinfektimin dhe sterilizimin e tyre.
- c) Jep dhe merr informacion për të gjitha rastet që ai ka informacion rreth interventeve dhe manipulimeve të ndryshme tek kirurgu dhe kolegët e tij. Më pas, i pasqyron ato saktë në regjistrin e mjekimeve, diagnozën infermiore, mjekimin, llojin e dëmtimit dhe faktorët dëmtues.
- d) Mund të kryejë procedura të mikrokirurgjisë/mjekimit të plagëve apo të ndihmës së parë dhe kujdeset që të gjitha këto të pasqyrohen me emrin e infermierit dhe të kirurgut që asiston në dhënien e shërbimit.
- e) Mban rregullin dhe qetësinë në kompleksin operator për kohën që është në punë.
- f) Kontrollon mjetet, garzat dhe instrumentet kirurgjikale për gatishmërinë dhe kushtet e sterilitetit dhe i shënon ato në një libër të veçantë për datën e sterilizimit.
- g) Punon në bazë të grafikut dhe llojit të punës që i cakton kryeinfermieri.
- h) Është pjesë aktive e trajnimeve të ndryshme të organizuara nga kryeinfermieri dhe Drejtoria e Spitalit që kanë të bëjnë me përmirësimin e shërbimit në drejtim të të sëmurëve.
- i) Për çdo problem apo mangësi në repartin e kirurgjisë lajmëron menjëherë kryeinfermierin.

Neni 22 - Teknik i Laboratorit

1). Detyrat dhe përgjegjësitë

- a) Të njohë të gjithë metodologjinë analitike që kryhet në laboratorin biokimik-klinik, bakteriologjik, gjenetik, anatomo-patologjik dhe imunologjik.
- b) Të njohë aparaturat dhe të kryejë shërbimet ditore të mirëmbajtjes së tyre.
- c) Të përgatisë reagentët e nevojshëm për analizat ditore dhe të urgjencës.
- d) Të ekzekutojë sipas rregullores shëndetësore analizat e të mbajë në rregull dokumentacionin përkatës.
- e) Të përgjigjet për analizat e sektorit ku punon dhe aparaturat e këtij sektori.
- f) Jep kontribut në realizimin cilësor të punës në laborator.
- g) Përgjigjet para hierarkisë për cilësinë e punës së kryer.
- h) Raporton para hierarkisë për problemet teknike gjatë shërbimit 24-orësh.
- i) Të ketë njohuri specifike lidhur me sektorin ku punon .
- j) Realizon numrin e ekzaminimeve dhe saktësinë e tyre në njësinë përkatëse diagnostikuese.
- k) Kontribuon për rritjen e besueshmërisë në cilësinë e analizave, për dhënien e përgjigjeve të ekzaminimeve si dhe për plotësimin korrekt të fletë analizës.

- l) Zbaton me korrektësi rregullat higjiëno-sanitare të vendit të punës.
- m) Realizon një bashkëpunim efektiv në aspektin tekniko-profesional midis anëtarëve të stafit të laboratorit.
- n) Angazhohet në rritjen e vet të vazhdueshme tekniko-profesionale.
- o) Kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga eprorët.

Neni 23 - Teknik i Imazherisë

1). Detyra dhe përgjegjësitë:

- a) Kujdeset për mirëmbajtjen dhe funksionimin e aparaturave dhe mjeteve të punës.
- b) Përgjigjet për cilësinë e produktit, si dhe zbatimin e procedurave përkatëse imazherike.
- c) Përgjigjet për menaxhimin e materialeve të konsumit në njësinë ku ushtron aktivitetin e tij.
- d) Mban dokumentacionin përkatës.
- e) Kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga eprorët.
- f) Të njohë aparaturat dhe të kryejë shërbimet ditore të mirëmbajtjes së tyre.
- g) Të përgjigjet për ekzaminimet e kryera dhe aparaturat e sektori ku punon.
- h) Përgjigjet para hierarkisë për cilësinë e punës së kryer.
- i) Raporton para hierarkisë për problemet teknike gjatë shërbimit 24-orësh.
- j) Zbaton me korrektësi rregullat higjiëno-sanitare të vendit të punës.
- k) Realizon një bashkëpunim efektiv në aspektin tekniko-profesional midis anëtarëve të stafit të laboratorit.
- l) Angazhohet në rritjen e vet të vazhdueshme tekniko-profesionale.
- m) Kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga eprorët.

Neni 24 - Fizioterapia

1). Detyrat e Përgjegjësit të Fizioterapisë:

- a) Përgjigjet për aplikimin e procedurave fizioterapeutike si në spital ashtu dhe në Klinikën e Fizioterapisë.
- b) Bashkëpunon me mjekët specialistë përkatës për llojin dhe kohëzgjatjen e procedurave të duhura fizioterapeutike sipas nomenklaturave të sëmundjeve dhe gjendjes së pacientit.
- c) Përgjigjet për mirëmbajtjen e aparaturave dhe shfrytëzimin racional të tyre.
- d) Përgjigjet për kualifikimin e vazhdueshëm të personelit të mesëm fizioterapeutik.
- e) Kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga eprorët.

2). Detyrat e Fizioterapistit:

- a) Përgjigjet për aplikimin e procedurave fizioterapeutike për të sëmurët e caktuar nga mjeku specialist apo konsulta e përbashkët.
- b) Plotëson dokumentacionin përkatës të kartelës fizioterapeutike të pacientit sipas diagnozës, procedurës fizioterapeutike, kohëzgjatjen dhe rezultatin e pritur.
- c) Bashkëpunon me mjekun kurues për rezultatin apo mos rezultatin e mjekimit fizik apo ndonjë efekt anësor si pasojë e fizioterapisë.
- d) Përgjigjet për mirëmbajtjen, mirë përdorimin dhe shfrytëzimin racional të aparaturave.
- e) Bën përpjekje për kualifikimin e tij të vazhdueshëm.

- f) Përgjigjet për mbajtjen pastër dhe në rregull të mjediseve të punës.
- g) Kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga eprorët.

Neni 25 - Sanitar/përgjegjës për pastrimin

1). Detyrat e sanitarit/përgjegjës për pastrimin:

- a) Sanitari/përgjegjësi i pastrimit ka për detyrë mirëmbajtjen dhe pastrimin e strukturës spitalore, mjediset e brendshme dhe të jashtme, duke respektuar të gjithë standardet, normat dhe protokollet e pastrimit.
- b) Respekton me përpikëri orarin e punës duke u treguar bashkëpunues me stafin e spitalit.
- c) Zbaton detyrat që merr kryeinfermieri përgjegjës për të arritur një cilësi të lartë në shërbim.
- d) Angazhohet në procesin e transportit të të sëmurëve brenda mjediseve të spitalit sipas udhëzimeve të kryeinfermierit.
- e) Bashkëpunon me kryeinfermierin dhe infermierët për parandalimin e infeksioneve spitalore.

Neni 26 - Fizikant Shëndetësor

1). Objekti i punës së fizikantit shëndetësor është bashkëpunimi për planifikimin dhe zhvillimin e trajtimeve radiologjike dhe të radioterapisë, duke siguruar zbatimin dhe respektimin e normativave në fuqi mbi mbrojtjen nga rrezet.

2). Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- a) Bashkëpunon në mirëmbajtjen dhe zhvillimin në siguri dhe me cilësi të burimeve rrezatuese, duke respektuar rregullat.
- b) Optimizon mbrojtjen nga rrezatimet për pacientët dhe personelin.
- c) Ndihmon në kërkimin dhe trajnimin në fushën e fizikës shëndetësore, në veçanti atë të radioterapisë dhe të rrezatimit.
- d) Kryen kontrole teknike dhe të cilësisë mbi pajisjet që përdoren në mjekësinë nukleare me qëllim garantimin e cilësisë dhe optimizimin e shërbimeve radiologjike.
- e) Mat dhe vlerëson dozat e rrezatimeve ndaj pacientit dhe personelit shëndetësor dhe garanton konformitetin e mjediseve të punës me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- f) Ofron mbështetje të drejtpërdrejtë për aktivitetin shëndetësor, në veçanti për zhvillimin e planin të trajtimeve me rreze.

Neni 27 - Inxhinier Klinik

1). Objekti i punës është monitorimi dhe zhvillimi i sigurisë teknike të pajisjeve shëndetësore me qëllim rritjen e sigurisë për pacientët, përdoruesit, si dhe përdorimin e tyre me efikasitet.

2). Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- a) Konsultohet nga personeli i spitalit për gjithçka që lidhet me përdorimin, blerjen dhe shpërndarjen e pajisjeve shëndetësore.
- b) Përgjegjet për zgjidhjen e të gjitha çështjeve lidhur me pajisjet shëndetësore në përputhje me ligjet, rregullat, standardet dhe rekomandimet përkatëse lidhur me to.
- c) Bashkëpunon me Drejtorin Shëndetësor dhe Drejtorin Administrativ për procesin e blerjes, pranimit, përdorimit, mirëmbajtjes, shpërndarjes dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të pajisjeve shëndetësore.
- d) Menaxhon procesin e inventarizimit të pajisjeve shëndetësore, duke mbajtur përgjegjësi për mënyrën e mbajtjes dhe saktësinë.
- e) Jep mendime teknike të vlefshme në rast të defekteve të vështira për pajisje të ndërlikuara.
- f) Mban përgjegjësi për pajisjet në afërsi të pacientit, të lidhura me pacientin dhe/ose të nevojshme për diagnostikimin ose trajtimin e tij.
- g) Mban përgjegjësi për kryerjen e shërbimeve, riparimeve të pajisjeve mjekësore, planifikimin dhe kryerjen e mirëmbajtjes parandaluese në përputhje me udhëzimet e prodhueseve.
- h) Organizon kontrollet e rregullta të sigurisë për të provuar që pajisja funksionon në përputhje me standardet përkatëse.
- i) Mban përgjegjësi për marrjen në dorëzim të pajisjeve mjekësore lidhur me funksionimin, sigurinë si dhe konfirmon që në momentin e dorëzimit është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në porosinë për blerje.
- j) Në bashkëpunim me përgjegjësin e blerjeve, ndihmon në procesin e blerjes, shërbimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore.
- k) Menaxhon projekte lidhur me instalimin e pajisjeve dhe ofrimin e konsulencës teknike në planifikimin e projekteve të reja si dhe në komunikimin me furnizuesit e spitalit për pajisje mjekësore.
- l) Mbikëqyr realizimin e kontratave të shërbimit nga kompanitë private të cilat lidhen edhe me trajnimin e personelit shëndetësor që përdor pajisjet shëndetësore si dhe për mbështetjen e këtij personeli lidhur me sigurinë gjatë përdorimit të pajisjeve.

Neni 28 - Kontrolli i Infeksioneve Spitalore

1). Në punën e SZKM një rëndësi e veçantë i kushtohet menaxhimit të riskut dhe parandalimit të infeksioneve spitalore. Për këtë qëllim parashikohet një plan pune i përditësuar periodikisht dhe funksionojnë organizma të dedikuara si vijon:

2). Komiteti i Kontrollit të Infeksioneve KKI

- a) Anëtarë të KKI janë përfaqësues të departamenteve shëndetësore, infermiore, të inxhinierisë, administrative, farmacistë dhe mikrobiologjisë.
- b) Komiteti formulon politikat për parandalimin dhe kontrollin e infeksionit. Një anëtar i komisionit zgjidhet kryetar dhe ka qasje të drejtpërdrejtë me drejtuesin e spitalit.
- c) Komisioni mblidhet rregullisht dhe jo më pak se tre herë në vit.

3). Ekipi i Kontrollit të Infeksioneve EKI

- a) Anëtarët e EKI janë zbatuesit e masave të përditshme për kontrollin e infeksioneve.
- b) Përgjegjësi i Kontrollit të Infeksioneve (PKI)
- c) Përgjegjësi i Kontrollit të Infeksioneve është zakonisht një infeksionist, mikrobiolog ose mjek tjetër me interes për infeksionet e lidhura me spitalin.

4). Funkcionet e Përgjegjësit të Kontrollit të Infeksioneve:

- a. Sekretar i Komitetit të Kontrollit të Infeksioneve dhe përgjegjës për regjistrimin e procesverbaleve dhe organizimin e takimeve;
- b. Anëtar konsulent i Komitetit të kontrollit të Infeksioneve dhe udhëheqës i ekipit të kontrollit të infeksioneve;
- c. Identifikon dhe raporton patogjenët dhe ndjeshmërinë e tyre ndaj antibiotikëve;
- d. Analizon dhe shpërndan të dhënat e rezistencës ndaj antibiotikëve, patogjenëve në zhvillim dhe gjetjet e pazakonta laboratorike;
- e. Mbikëqyr infeksionet spitalore dhe bën zbulimin e shpërthimeve infektive;
- f. Bën investigim të shpërthimeve infektive;
- g. Është përgjegjës për trajnimin dhe edukimin me procedurat dhe praktikën e kontrollit të infeksionit.

5). Infermierja e Kontrollit të Infeksionit (IKI)

Një infermiere nga stafi i spitalit ngarkohet për këtë funksion. Infermieret e kontrollit të infeksioneve duhet të trajnohen në teknikat bazë mikrobiologjike.

Detyrat dhe përgjegjësitë Infermierit të Kontrollit të Infeksionit IKI:

- a. Të koordinojë punën ndërmjet departamentit të mikrobiologjisë dhe departamenteve klinike për zbulimin dhe kontrollin e infeksioneve spitalore;
- b. Të bashkëpunojë me Përgjegjësin e Kontrollit të Infeksioneve për mbikëqyrjen e infeksionit dhe zbulimin e shpërthimeve;
- c. Mbledhja e ekzemplarëve dhe përpunimi paraprak;
- d. Trajnimi dhe edukimi nën mbikëqyrjen e përgjegjësit të kontrollit të infeksioneve;
- e. Rritja e ndërgjegjësimi i pacientëve dhe vizitorëve për kontrollin e infeksionit.

Miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Spitalit Zoja e Këshillit të Mirë më datë 09.06.2022.